

EVALDA PACI

HISTORIA E LETËRSISË SË SHKRUAR SHQIPE NË BOTIME TEMATIKE ME VËSHTRIM SISTEMATIZUES (1950-1985)

Abstrakt

Me vëmendjen që ka marrë sërish kohët e fundit çështja e ripërpilimit të historisë së letërsisë së shkruar shqipe, rikthimi ndaj modeleve të mëhershme të realizimit të saj përbën një shtysë të fortë reflektimi mbi çështje të konsiderimit të dëshmive më të hershme shkrimore të shqipes, por dhe të mbarë trashëgimisë kulturore që transmetohet në kapituj, trajtesa e zëra më vete në përbërje të botimeve të mëparshme mbi të njëjtin argument. Të para dhe me syrin kritik disa dekada më vonë, por dhe të krahasuara mes tyre nga studiuesit e fushës, të tilla botime, ndër të cilat dhe disa me destinacion shkollor, përbëjnë objekte të një vëmendjeje të shtuar në kohët e fundit, aq më tepër nëse bëhet fjalë për gjurmimin e një metodologjie të paraqitjes së autorëve, përpiluesve të veprave, por dhe të punimeve tematike mbi historinë e letërsisë së shkruar shqipe. Në këtë trajtesë u përzgjedh një periudhë kohore (1950-1985) në të cilën kanë gjetur përmbushje disa punime të kësaj natyre, por të ndryshme mes tyre, dhe me një prirje jo të njëjtë në paraqitjen e zërave autorialë dhe të veprave përkatëse.

Fjalë kyçe: *histori e letërsisë, letërsi e shkruar, autorë, botime tematike, modele ndërtimi*

Studimet paraardhëse mbi historinë e letërsisë së shkruar shqipe, në veçanti iniciativat institucionale që kanë një format të qartë të një pune kolegjiale mbeten një objekt referimi më se i qartë në rasat kur nevojitet të përshkruhet një itinerar analitik i një panorame studimore që duke dashur të përqendrohet dhe në shkallën e njohjes së veprave më të veçanta, duhet të marrë parasysh një ecuri konkrete gjurmimesh dhe trajtesash paraprijëse. Vështrimet mbi autorë, tekste dhe vepra të letërsisë së shkruar shqipe kanë pasur që në krye të herës një prirje të qartë të një përmbajtjeje të një niveli të arrirë shkencor dhe një fakt i tillë ka mbizotëruar në çdo sprovë mbi argumentin e sipërpërmendur, dhe në rasë të përpilimit të botimeve më modeste për nga vëllimi, por gjithnjë cilësore për nga brendia dhe orientimet metodologjike. Një sprovë e qartë në këtë vështrim duket që është marrë përsipër dhe nga Eqrem Çabej në vitet '30 të shekullit të kaluar, për t'u pasuar

më tej me trajtesa më të thelluara, që përmbajnë dhe shtjellime me interes mbi rryma dhe prirje të veçanta në letërsinë shqipe, përfshirë dhe atë të lëvruar në trevat arbëreshe.¹

Historia e letërsisë së shkruar shqipe, si një sfidë që bashkëhartuesit e botimeve përkatëse i vë përballë një sërë refleksionesh e kriteresh për t'u përcaktuar, apo për t'u bërë me dije para lexuesit e studiuesit të interesuar, e konkretizuar në botime të një natyre të mirëfilltë institucionale, përbën një objektiv ndaj të cilit vëmendja e gjurmuesve më të mirë të kësaj letërsie nuk mund të quhet kurrsesi e munguar. Kohët e fundit është rikthyer vëmendja ndaj çështjesh që kanë të bëjnë me një model konceptimi të historisë së letërsisë së shkruar shqipe, duke bërë të domosdoshme dhe referimin ndaj modelesh të mëparshme të realizuara dekada më parë, natyrisht dhe mbi bazë modelesh përpilimi që në ditët e sotme duhen riparë në disa vështrime. Tekstet studimore paraprijëse mbi historinë e letërsisë shqipe dhe më konkretisht, me trajtesa që kanë në qendër të vëmendjes letërsinë e vjetër shqipe përbëjnë dhe sot e kësaj dite një bazë të mirë burimore në shumë pikëpamje për gjurmimet mbi këtë lamije dhe periudhën përkatëse. Çdo rikthim ndaj punimesh të mëparshme, të realizuara në kohë të ndryshme, por me një objektiv të orientuar ndaj historisë së letërsisë së shkruar shqipe dhe arealeve kryesore të lëvrimin të saj risjell në vëmendje botime të mëhershme, disa prej të cilave dhe të paracaktuara për përdorim gjimnazik, por me një vështrim të qartë ndaj periudhave më të rëndësishme të kësaj të fundit.²

¹ E. Çabej, *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe (me pjesa të zgjedhura për shkollat e mesme)*, Shtypshkroja e Ministrisë s'Arsimit, Tiranë, 1936. Pak më i hershëm në kohë paraqitet dhe botimi i Papas Gaetano Petrottës (1882-1952), me titull *Popolo, lingua e letteratura albanese*, botuar së pari në Palermo në vitin 1931 e ribotuar një vit më vonë, në 1932, me një përmbajtje të qartë të orientuar ndaj historisë së letërsisë së shkruar shqipe e të shtypit kulturor e letrar, me një vëmendje të drejtuar ndaj dëshmime shkrimore të shqipes e të individualiteteve të studimit të saj në disa areale të rëndësishme. Informacioni i gjerë që gjurmohet në këtë veprës të Gaetano Petrottës shtjellohet në disa kapituj, ndërkohë që gjinden të dhëna me vlerë mbi ente shtypi të së njëjtës periudhë e mbi studime paraardhëse apo të asaj kohe mbi çështje të historisë së gjuhës e të letërsisë shqipe.

² Të vështuara si modele referenciale dhe në vijimësi, në veçanti ato të përpiluara mbas viteve '40 të shekullit të kaluar, librat shkollorë që janë dhe sprova në pikëpamje të reflektimit të përpjekjeve për t'i qëndruar vëmendjes ndaj historisë së letërsisë shqipe dëshmojnë prirje të veçanta në vështrime mbi autorë të veçantë të letërsisë së vjetër shqipe, duke u plotësuar me tekste të përzgjedhura dhe me shënime të natyrës biografike për këta të fundit. Shih në veçanti vëllimin me titull *Letërsia e vjetër shqipe dhe arbëreshe, Tekst për kl. III të shkollave të mesme*, Tiranë, 1952, në të cilin përfshihet dhe një trajtesë e gjerë mbi letërsinë e vjetër shqipe, bashkë me konceptimin e shtrirjes në kohë, si dhe me nënndarje të shtjelluara në pjesë të veçanta të hyrjes së

Hapa konkretë janë hedhur në këtë drejtim në periudha të ndryshme të zhvillimit të mendimit letrar e studimor mbi çështjet themelore të strukturimit të kësaj historie, e domosdoshme për këdo që në interesat e veta ka në vëmendje autorë e vepra, tekste e përpilues përkatës, por dhe rrethana që kanë qenë në më të shumtën e rasteve faktorë ndikues në zhvillimet e prirjeve letrare e në shkrimtarinë e individualiteteve që nuk kanë qenë të pakta në historinë tonë.

Pavarësisht konsiderimit konkret të arritjeve paraardhëse në botimet që do të merren në shqyrtim dhe në këtë punim tonin, prurje me një peshë të caktuar, krijime letrare të disa gjinive, sprova që paraqiten si përpjekje për të risjellë në vëmendje apo për të paraqitur të përafuara për lexim pjesë të rëndësishme të veprave të letërsisë së shkruar shqipe kanë paraprirë punimet e një karakteri institucional, në të cilat qoftë dhe si fakte kujtuese edhe reflektohen disa prej tyre.

Në çdo përpjekje për të gjurmuar njëfarë vijimësie në pikëpamje botimesh institucionale të orientuara ndaj evidentimit të studimeve dhe vetë veprave që e shënojnë letërsinë e shkruar shqipe në periudhat më të rëndësishme të saj, studime të veçanta, që janë përpiluar duke pasur parasysh shkrimtarinë e ndonjë autori të përveçëm, të rëndësishëm për kohën, por dhe për prodhimtarinë e tij mbeten parësore për të vijuar më tej me punime që paraqiten si tematike për një sërë arsyesh. Interpretimet ndaj brendisë së tyre në ditët e sotme mund të jenë lirisht objekt vështrimesh kritike, të domosdoshme në raste të caktuara, aq më tepër që kujtesa mbi kontributet përkatëse, në veçanti mbi punimet tematike apo botimet e specializuara nënkupton rimarrje vëmendjeje dhe një rinjohje meritash më se të arsyetuara.³

Në botimet institucionale dhe që paraqiten të realizuara nën një objektiv të tillë, do të mund të gjejmë orientimet ndaj periudhave përkatëse, lidhjeve të kuptueshme me arritjet në fushë të historisë së shkrimit, por dhe një referencialitet të domosdoshëm ndaj vlerës së veprave themelore për çdo ndarje a rrymë që përfshihet në historinë e letërsisë së shkruar shqipe. Mes botimesh të një paracaktimi të kësaj natyre në studimet tona mund të qëmtohen dallime, rishikime, por dhe diversitet pikëpamjesh, dhe pse këto të fundit ndahen prej njëri-tjetrit në disa dekada.

botimit. Në lidhje me tekstet e përzgjedhura nga kjo letërsi, bie në sy dhe kujdesi për t'i përafuar pjesët përkatëse në pikëpamje të tejshkrimit dhe pajisja me një aparat modest kritik në mbyllje të gjithsecilës prej tyre.

³ Shih ndër të tjera dhe M. Gurakuqi, "Poeti e patrioti Ndre Mjeda", në *Buletin i Shkencave Shoqërore*, n.3, 1956, ruajtur dhe si dorëshkrim në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë. Shih gjithashtu, po ai, *Autorë dhe probleme të letërsisë përparimtare shqipe të viteve '30*, Tiranë, 1966.

Vështrimet mbi periudhat dhe mbi autorët përkatës nuk janë përherë të njëjta, ndërkohë që një fakt i tillë shtyn të vlerësojmë dhe dobinë e konkretizimit të kontributeve të veçanta në punime të tilla, që mbeten dhe dëshmi e sprovave të mëhershme për të evidentuar vlerat e veprave të historisë së letërsisë së shkruar shqipe, në veçanti në periudhat më të hershme të dokumentimit të saj.⁴

Studimet paraardhëse mbi historinë e letërsisë së shkruar shqipe, në veçanti iniciativat institucionale që kanë formatin e qartë të një pune kolegjiale mbeten një objekt referimi më se i qartë në rasat kur nevojitet të përshkruhet një itinerar analitik i një panorame studimore që duke dashur të përqendrohet dhe në shkallën e njohjes së veprave më të veçanta, duhet të marrë parasysh një ecuri konkrete gjurmimesh dhe trajtesash paraprijëse.

Tekstet studimore paraprijëse mbi historinë e letërsisë shqipe dhe më konkretisht, me trajtesa që kanë në qendër të vëmendjes letërsinë e vjetër shqipe përbëjnë dhe sot e kësaj dite një bazë të mirë burimore në shumë pikëpamje për gjurmimet mbi këtë lamije dhe periudhën përkatëse. Vëmendja ndaj veprave që e përfaqësojnë këtë letërsi është shfaqur në botime e përpjekje për të risjellë në objekt të studimit pjesë të veçanta e domethënëse të brendisë së tyre, por më tej, dhe me studime që i kanë parë në një sërë dimensionesh, përfshirë dhe vlerat që mund t'u njiheshin në vështrime më të gjera, që kishin të bënin drejtpërdrejt me historinë e letërsisë së shkruar shqipe. Dokumentimi shkrimor mbi njohjen e tyre dhe të autorëve përkatës shtrihet në materiale të një natyre historiografike, por dhe në trajtesa që janë ruajtur për një kohë të gjatë në arkivat tona, përfshirë dhe arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë.

Dokumentimi shkrimor i gjuhës sonë është mbështetur gjerësisht nga vepra të një letërsie specifike për nga tematika, e cila është emërtuar si *letërsi e vjetër shqipe*, *letërsi kishtare*, *letërsi kishtare në gjuhën shqipe* etj. Ndarja e saj prej zhvillimesh të përafërta në kohë e në areale jo të njëjta, por dhe përafrimi në pikëpamje objekti nga studiues të caktuar nuk është dhe aq e lehtë, duke

⁴ Pothuaj në çdo sprovë që në momente të caktuara të zhvillimeve letrare merr përsipër dhe trajtimin kronotematik të çështjeve të letërsisë së vjetër shqipe, analizohet dhe njëfarë përcaktimi konkret i kufijve kohorë të shtrirjes së saj. Një botim që duhet marrë në konsideratë e që reflekton dhe vlerësimin e një argumenti të tillë mbetet ai me titull *Historia e letërsisë shqipe, I*, Tiranë, 1959, në të cilin në krerë të caktuar do të mund të gjendet dhe një pasqyrë e pikëpamjeve gjegjëse mbi këtë të fundit. Një ndërthurje traditash letrare e shkrimore bën të mundur që emërtimi “letërsi e vjetër shqipe” të vështrohet në receptimin konkret të saj, edhe në pikëpamje prurjesh konkrete, që vijnë nga areale të ndryshme gjeokulturore. Shih në veçanti *Historia e letërsisë shqipe, I*, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1959, f. 139-147. Shih gjithashtu dhe Sh. Sinani, *Historishkrimi letrar dhe disa dukuri ndërkulturore*, Botime ASHAK, Prishtinë, 2009, f. 76-77.

pasur parasysh që shumë vite më parë, projektet individuale në lidhje me çështje të historisë së letërsisë së shkruar shqipe ishin të ndryshme që në pikënisje, apo dhe në motivimin përkatës.

Emërtimi "*letërsia e vjetër shqipe*" përkon më shumë me periudhën kohore që zakonisht mbetet në caqet kohore të shekujve XVI-XVII, periudhë domethënëse që duke u njohur dhe më thellë falë një dokumentacioni më të disponueshëm në dekadat e fundit, ka rimarrë vëmendje dhe vitet e fundit. Si kuadër kohor, shekulli XVI është i karakterizuar nga ndryshime që pasojnë njëri-tjetrit e që nuk mund të kalojnë pa vëmendje as në lidhje me zhvillimet që e projektojnë botën e librit të shtypur, të letërsisë humaniste, biblike gjithashtu në një mënyrë të re, por jo dhe të shkëputur nga ç'ndodhte më herët në Evropë. Vetë shkrimi shqip dhe letërsia përkatëse në gjuhën tonë dëshmojnë me vepra e përpilime konkrete përgjatë shekullit XVII, madje të realizuara në ente shtypi të rëndësishme për kohën e më tej, të karakterizuara nga tipare që i bëjnë këto të fundit të veçueshme për nga tematika si dhe veçori të tjera.⁵

Edhe në lidhje me autorët klasikë që mbeten referencialë për letërsinë evropiane dhe në shekujt e sipërcituar, ndryshimet në kulturën e përhapjes së librit dhe të qarkullimit të tij qenë shënuese dhe me një efekt ndikues në rrethe të caktuara kulturore. Studimet mbi këtë periudhë dhe tekstet përfaqësuese të saj janë të karakterizuara nga një sërë arritjesh që në të vërtetë dallojnë mes tyre në shumë pikëpamje, qoftë dhe të objektit që në varësi të interesave dhe të vetë periudhave konkrete përqendrohej në pjesë të veçanta, në rigjetje ekzemplarësh dhe qasje jo të njëjta metodologjike të vështrimeve mbi to, si dhe në trajtime që mëtonin t'i jepnin kësaj ndarjeje kohore e tematike një kontekstualizim më se të domosdoshëm. Në veprimtaritë institucionale të viteve të fundit kemi pasur mundësi të shprehemi në lidhje me kontribute që duke qenë të lidhura që në pikënisje me historinë e letërsisë së shkruar shqipe, reflektojnë në të njëjtën kohë prirje metodologjike të konteksteve që kanë ndikuar në formimin e autorëve dhe pikërisht ndaj letërsisë sonë ka pasur e ka vijuar të ketë dhe në mënyrë paralele në vise të caktuara orientime jo të njëjta ndaj çështjes së përpilimit të historisë së letërsisë dhe të konsiderimit të kriterëve për ta kontekstualizuar sa më qartësisht këtë të fundit.

⁵ Në punimet mbi historinë e letërsisë së shkruar shqipe u është lënë përherë një hapësirë e konsiderueshme veprave dhe autorëve të letërsisë së vjetër shqipe. Janë ndërtuar në lidhje me këta të fundit kapituj të veçantë, janë renditur konsiderata mbi formimin përkatës, vlerat e spikatura që ofronte shkriktaria e tyre, tiparet gjuhësore dhe letrare që viheshin në dukje në lidhje me pjesë të rëndësishme të veprat e tyre. Për autorë të përveçëm vihet në dukje qoftë fakti që kanë përpiluar modele veprash të një rëndësie të veçantë për kohën, qoftë dhe për vijimësinë në elemente të caktuara që konstatohej në autorë të periudhave të mëvona.

Të afërta në kohë me botime të natyrës institucionale mbeten punime tematike që duke u paraqitur nën objektivin e analizimit të teksteve më të përveçme për nga destinacioni, ndihmojnë dhe në konceptimin e një kategorie të veçantë përmbajtësore, që jo vetëm ka zënë vend në trajtesat mbi historinë e letërsisë së shkruar shqipe, por dhe ka qenë një tjetër premisë që këto të fundit të jenë objekt i një vëmendjeje jo vetëm institucionale, por dhe i vështrimeve ndërdisiplinore, të domosdoshme kur bëhet fjalë për fragmente, të përfshira në materiale dokumentare të një referencialiteti të veçantë. Të tilla tekste, mbeten themelore për punime që mbështeten mbi kriteret e periodizimit, që nuk lënë jashtë vëmendjes as çështje të brendisë, por na për afrojnë me trajtesa mbi probleme të ngjashme në tradita të tjera, në veçanti në ato të arealit ballkanik.⁶

Çështja kombëtare është nënvizuar jo rrallë në trajtesat mbi letërsinë e vjetër shqipe e një fakt i tillë del në pah veçanërisht nëse u referohemi atyre shtjellimeve më të thelluara që duke u ndalur në analiza mbi hollësi që disponohen nga letërkëmbimi i kohës, apo nga tekste introductive në veprat përkatëse, bëjnë të dalë në pah dhe një prirje e tillë në veprimtarinë e autorëve të kësaj të fundit. Ndërkohë, siç dhe do të mund të vërehet nga kontribute të viteve të fundit, por dhe nga përpilime të botuara në kontekste të tjera në periudha më të afërta, një analizë e ekzemplarëve të botimit a ribotimit të veprave të autorëve të letërsisë së vjetër shqipe do ta paraqiste të plotë panoramën përkatëse mbi një periudhë të tillë, e evidentuar hershëm në kontributet e filologëve dhe studiuesve të huaj, që qysh në dekadat e para të shekullit të kaluar bënë me dije praninë e kësombllave përkatëse në biblioteka apo fonde arkivore të rëndësishme evropiane.

Në botime të mëvona, në veçanti në atë të vitit 1983 gjurmohen trajtesa më të sistemuara në lidhje me autorë të veçantë, qoftë dhe të traditës arbëreshe, e parë në pikëpamje të prodhimtarisë letrare në Kalabri dhe në Sicili.⁷

Vetë trajtesat që reflektohen si në lidhje me periudhën e letërsisë së vjetër shqipe, ashtu dhe me autorë të veçantë të saj, paraqesin përherë shtrimin e

⁶ Me botimin e vitit 1959 rreth historisë së letërsisë së shkruar shqipe jemi marrë dhe më parë, në veçanti kur në kuadër të konferencës shkencore “*Studime letrare në proces, perspektiva e qasje të reja zhvillimi*”, (mbajtur më 27 qershor 2022), tashmë në proces botimi, kemi marrë në shqyrtim ndihmesa që duke u paraqitur në formate të ndryshme për arsye të objektivave të autorëve përpilues, i shërbenin në mënyrën e vet studimit më të thelluar të autorëve të veçantë, që në të vërtetë janë dhe përfaqësues të një periudhe mjaft domethënëse për vijimësinë e shkrimit shqip, të traditave letrare që do ta bënin letërsinë shqipe të ishte e tillë, të një sërë formash të shprehjes së mendimit që janë shënueset për çdo kulturë.

⁷ Shkrimin shqip dhe atë në arbërisht e kanë shënuar në mënyrë decizive autorë që duke u përfshirë në një traditë që kishte të bënte me risitë e kohës dhe sa i përket historisë së shtypshkrimit, mbeten themelore dhe për çështjet e karakterit filologjik dhe të historisë së veprave të tyre, që duhen shtruar me të drejtë në raste të tilla.

pikëpyetjes nëse konsiderata apo interpretime të caktuara lidhen me vetë kohën në të cilën u realizuan të tilla botime, të ndara në kapituj e krahë të veçantë, apo dhe me mungesën e disponimit të një dokumentacioni që gjithsesi dhe po të zotërohej gjerësisht, do të kërkonte një tjetër hapësirë trajtimi dhe shtjellimi. Edhe sa i përket mënyrës së citimit e të përafrimit të autorëve, të cilët në veçanti në botimin e vitit 1983 kanë zënë një hapësirë të konsiderueshme, mund të thuhet që do të reflektohet në mënyrë referenciale më shumë në përmbyllje të vëllimit, fakt që na përtafron me të tjera botime të asaj periudhe ose të disa viteve më parë.

Shënimet e bollshme në fund të faqeve të botimit të sipërcituar kanë gjithashtu vlerë të mirëfilltë referenciale, në veçanti në lidhje me historikun e njohjes, receptimit të veprave të caktuara, shoqëruar dhe me shpjegime të domosdoshme mbi përfshirjen e autorit (autorëve) në rrethana të caktuara shoqërore, por dhe ndikimet e mundshme nga tradita të tjera letrarësie.⁸ Jo rrallë do të mund të ndihet dhe një pengesë reale në analizimin e përjetimeve të autorëve të veçantë, ndër të cilët dhe ata të letërsisë shqipe me alfabet arab, tek të cilët mund të mbivlerësohen ndikimet nga zhvillimet e kohës, në vend që të reflektohet thjesht për aspektin gjinor të krijimeve apo tipareve që mund t'i përtafrojnë të tillë autorë me të tjera rryma letrare. Sa u përket vlerësimeve që kanë të bëjnë me konceptimin e ndikimeve të mundshme në shkrimtarinë e autorëve të caktuar, të pranishme dhe në botimin e vitit 1959 (me autorë përpilues Dh. Shuteriqi, K. Bihiku, M. Domi, V. Bala, Z. Kodra, Z. Sako), duhet thënë që po të ishin mënjeluar në një masë të konsiderueshme nga bashkëhartuesit e këtij të fundit, vetë vepra do të paraqitej në një tjetër format përpilimi.⁹

Për autorët e letërsisë së vjetër shqipe në përgjithësi synohet të jepen të dhëna biografike, madje dhe në rastin kur në lidhje me vitin e lindjes paqartësitë ishin të njëjta si në ditët e sotme. Sqarohen rrethana të formimit individual, mjaft të rëndësishme dhe duke pasur parasysh që kanë qenë ndikuese në rrugëtimin e mëtejshëm të secilit prej autorëve të kësaj periudhe.¹⁰

⁸ Citojmë ndër të tjera cilësime mbi gjini të veçanta letrare në lidhje me letërsinë shqipe në alfabetet orientale, *po aty, botim i cituar*, 1983, f. 62-63.

⁹ Shih në veçanti "Hyrje" në *Historia e letërsisë shqipe, I*, Tiranë, 1959, f. VII-XXXIII.

¹⁰ Duhet vënë në dukje që në botimin e historisë së letërsisë së shkruar shqiptare të vitit 1983, kapitujt kushtuar Rilindjes kombëtare dhe autorëve të saj janë ndër më të zgjeruarit dhe të shoqëruar me një aparat të pasur shpjegues. Autorët më të rëndësishëm janë trajtuar gjerësisht dhe me të dhëna që janë gjurmuar në revista shkencore, studime monografike e periodikë të huaj, ndërkohë që dhe vepra të veçanta e çështje të gjinive të lëvruara kanë marrë po aq vëmendje. Trajtesat kushtuar kësaj periudhe zënë një pjesë të konsiderueshme të vëllimit të këtij botimi, ndërkohë që dhe treguesi i emrave (*po aty, botim i cituar*, f. 609-626) që përmbyll këtë të fundit

Më vonë, do të mund të vihet në dukje që pothuaj në mënyrë paralele me realizimin e këtyre botimeve, studiues shqiptarë, po të ndodhur jashtë kufijve të vendit tonë, kishin finalizuar vepra të mbështetura mbi një dokumentacion të pasur, mjaft i vyer dhe për t'u përfshirë në lidhje me autorë të veçantë të traditës letrare e shkrimore të shekujve XVI-XVII.¹¹

Sa i përket shkrimtarisë së këtyre autorëve, vlerësimet e dhëna janë të rëndësishme, ndërkohë që nxisin përherë nevojën e krahasimit me tekste origjinale, që në pjesën më të madhe u kanë shërbyer këtyre të fundit në realizimin e doracakëve që mbas *Mesharit* të Buzukut, përbëjnë të parat referime librorë në lidhje me të njëjtën traditë letrare dhe shkrimore. Pikërisht në lidhje me një autor si Pjetër Budi, që dëshmon aftësi shkrimtarie në lëvrim tekstesh poetike si dhe tekstesh në prozë, nënvizohen veçori të shkrimit e të vënies në përdorim të teknikave metrike që siç dihet, dhe janë rimarrë në shqyrtim nga studiues të teksteve të vjetra shqipe.¹² Trajtësa që tërheqin vëmendjen për nga gjerësia e shtrirjes dhe veçantia e argumenteve janë pikërisht ato që janë përpiluar mbi autorë të Rilindjes, të cilëve u atribuohen vepra me karakter të qartë romantik, por dhe reflektues të njohjes së traditave shënuese në letërsi dhe në tiparet e saj.

Pikërisht në lidhje me autorë të kësaj periudhe, do të gjendet e parashtruar dhe mundësia e njohjes nga ana e tyre e shkrimtarëve paraprijës që kanë ndikuar në një letërsi më të përveçme, siç mund të konsiderohen prurjet letrare dhe dokumentare mbi heroin tonë kombëtar, Gjergj Kastriotin, trajtuar ndonjë shekull më parë nga një autor gjithashtu i rëndësishëm e gjerësisht i njohur, siç konsiderohej me të drejtë, Marin Barleti.¹³

Përpjekje të caktuara për t'i orientuar apo përafruar autorë që mund të kenë jetuar apo vepruar në treva jo të afërta, a në periudha jo krejt të afërta vërehen më tepër në krerë të natyrës përgjithësuese (i referohemi përherë botimit të vitit 1983), ndërkohë që disa vlerësime meritojnë një vështrim kritik nga pikëpamje të zhvillimeve të mëvona, të domosdoshme për të vënë në vend të paktën në çështje të metodës mënyrën si duhet parë apo trajtuar shkrimtaria e autorëve të letërsisë së shkruar shqipe. Periudha si ajo e letërsisë së vjetër

reflekton një sërë burimesh bibliografike, përfshirë dhe punime në dorëshkrim kushtuar studimit të veprave të Rilindjes sonë kombëtare.

¹¹ Shih në veçanti kreun V me titull "Rryma letrare e bejtexhinjve, në Historia e letërsisë shqiptare", Tiranë, 1983, f. 58-75.

¹² Shih në veçanti kreun kushtuar Pjetër Budit në *Historia e letërsisë shqiptare*, Tiranë, 1983, f. 35: Budi la disa mijëra vargje (3000). Ai është kështu edhe lëvruesi i parë i njohur i vjershërisë në historinë e letërsisë sonë, bashkë me arbëreshin Lekë Matrënga. E shumta e vjershave janë përkthime ose përshtatje nga latinishtja, ka edhe disa origjinale.

¹³ Shih sërish Sh. Sinani, *Historishkrimi letrar dhe disa dukuri ndërkulturore*, Botime ASHAK, Prishtinë, 2009, f. 75.

shqipe, por dhe të Rilindjes është vështirë tashmë të shihen me një kufi të prerë, aq më tepër që qysh vite më parë është vërejtur që ka pasur përkime, njohje të mundshme të botimeve përkatëse, apo të tipareve gjuhësore e letrare që janë ndërtuar në hapa të një gradualiteti që ka qenë i lidhur edhe me tematikat, edhe me zhvillimet e caktuara të kohës. Çështja e njohjes nga ana e autorëve e gjuhëve klasike për nga referencialiteti kulturor, formimi i spikatur që ka qenë karakteristik për këdo që ndërmerre sprova të shkrimtarisë e të përpilimit të veprave me një natyrë të qartë agjiografike, teologjike, apologjetike, mund t'i përbashkojë në vështrime më të thelluara këta autorë, dhe pse në pikëpamje formimi ka dhe është e natyrshme që të ketë dallime apo veçori të ndryshme.

Një çështje me vend që do të duhej të shtrohej në këtë kontekst aktual tonin, ndërkohë që studime kritike e filologjike mbi veprat e letërsisë shqipe, në veçanti të asaj të vjetër, të Rilindjes dhe asaj arbëreshe kanë pasuruar kuadrin e mundësisë për vëzhgime më të drejtpërdrejta, është pikërisht ajo mbi një variant të ri të historisë së letërsisë së shkruar shqipe, që sigurisht nga botimet e mëparshme do të duhet të vjelë më të mirën, në veçanti në pikëpamje metodologjike. Po ashtu, qëmtime me vlerë pas rihapjes së mundësive për të gjurmuar në arkiva të veçantë në të cilat kanë rezultuar të dhëna mbi autorë, shkolla e kolegje, vatra të rëndësishme edukative nga të cilat kanë dalë personalitete që e kanë përruruar shkrimin dhe letërsinë shqipe në shekuj të rëndësishëm për kulturën e librit, kanë ndikuar në rimarrjen e argumenteve të sipërcituara. Dekadat e fundit në veçanti janë karakterizuar nga një prodhimi të frytshme që ka shpënë sërish vëmendjen ndaj nevojës për të kryer analizime të drejtpërdrejta dokumentare, si dhe për të vënë në shërbim të studimeve më të thelluara botimet kritike e filologjike mbi vepra konkrete, ndër të cilat rendisim dhe ato të letërsisë së vjetër shqipe. Përtej faktit që këto botime ofrojnë një bazë të gjerë referenciale për përfshirjen në trajtesat mbi autorë të caktuar tekstet më përfaqësuese të veprave të tyre, dhe vetë punimet e tematizuara të përpiluesve a përgatitësve të këtyre botimeve janë një mbështetje e mirë për t'i bërë më të pasur krerët a kapitujt përkatës në vepra kolektive mbi letërsinë e shkruar shqipe.

Botime e sprova që janë iniciativa të mëhershme, por që janë përpiluar me një apo disa autorë, kanë qenë e mbeten për t'u konsideruar si mbështetje e shtysë që më tej të vijohet me trajtesa më të plota, që pikërisht për vetë objektin që ka pasur e duhet të ketë një botim me optikë të përqendruar në historinë e letërsisë së shkruar shqipe, janë sa të domosdoshme, aq dhe karakterizuese për këto të fundit.¹⁴

¹⁴ Tradicionalisht njihen si sprova kolegjiale e të dala nga një grup autorësh botimet e vitit 1959-1960 dhe më tej të vitit 1983, të bëra objekt studimi kritik dhe në dekadat e fundit në raste të diskutimit të modelit a modeleve të reflektimit në një histori letërsie të kritereve, të autorëve, dukurive, por dhe periudhave përkatëse. Të përpiluara në një

Çdo iniciativë që i kushtohet trajtimit të veprave të letërsisë sonë në një kuadër të tillë, përbën një ndihmesë të çmuar që në veçanti nëse bëhet fjalë dhe për tekste të një vështirësie të arsyetuar nga koha, faza përkatëse e zhvillimit gjuhësor e kulturor, por dhe të tjerë faktorë kryesisht historikë duhet konsideruar e marrë në vlerësim, aq më tepër që për një argument siç paraqitet historia e letërsisë sonë të shkruar është diskutuar gjerësisht, por asnjëherë mjaftueshëm për çështje të modelit e të dimensioneve që të tilla vepra, që ndërtohen mbi të tjera vepra, duhet të kenë.

Vetë historia e letërsisë sonë të shkruar përbën një pasuri më vete, si bartëse zhvillimesh që kombëtaren dhe shqiptarësinë e paraqesin në një sërë formash e qenësish, të rimarra në shekuj, të kulmuara në rasë të vënies në qendër të vëmendjes së heronjve e figurave të shquara të historisë sonë kombëtare, të reflektuara në vepra të ndryshme, të celebruara përmes tyre, por dhe falë ndjeshmërisë së autorëve që u kushtuan veprat e jetës varianteve doktrinare, mësimëve të katekezës, celebrimit të heroicitetit kombëtar ndaj pushtimeve të huaja, mbrojtësve të një identiteti për të cilin u luftua dhe në Evropë e viset fqinje. Aktualisht, rimarrja e diskutimit mbi një histori të rishikuar të letërsisë së shkruar shqipe nënkupton dhe rivlerësimin e kësaj pasurie, që rikthehet në vështrimet tona falë përpilimeve e hulumtimeve më të fundit mbi autorë e vepra, por dhe mbi zhvillimet më të rëndësishme të kohës në të cilët këto të fundit u realizuan.¹⁵ Do të jenë dhe këto arritje të dekadave të fundit, të pasuruara ndjeshëm dhe nga vetë botimet e natyrës kritike e filologjike, që përafrojnë studiuesit me tekstet dhe brendinë e veprave të shekujve më të hershëm të dokumentimit shkrimor të gjuhës sonë, si pararendëse të përpilimeve të mëvona, që me të njëjten tematikë qendrore vijojnë e shfaqen deri në fund të shekullit XIX e në dekadat e para të shekullit XX.

distancë kohore prej dy dekadash, të dy këto botime u referohen dhe dëshmime më të hershme shkrimore të gjuhës sonë, me përpjekjen për ta përfshirë natyrshëm dhe trashëgiminë kulturore që lidhet më së pari me historishkrimin e shqipes. Të ndryshme në shumë vështrime, botimet në fjalë mbeten sërish referenciale në pikëpamje të metodologjisë që është ndjekur që në konceptimin e punës, duke u diferencuar më tej dhe në çështje të aparatit kritik përkatës dhe të përmasave të përfshirjes së teksteve autoriale në përbërje të tyre. Materiale të tjera ruhen në dorëshkrim në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, përfshirë disa sprova për një vëllim të tretë mbi historinë e letërsisë shqipe, që duhet të dilte nga shtypi në fund të viteve '60, por pa e arritur këtë synim për arsye jashtëletrare. Shih në veçanti Besa Hoxha Beqiri, *Një histori letërsie e ndaluar, studim historiko-letrar dhe krahasues*, Botime Naimi, Tiranë, 2016.

¹⁵ B. Demiraj, *Areali kulturor i Veriut në shek. XVI-XVIII*, Botime Onufri, Tiranë, 2017.

BIBLIOGRAFI

- Abazi-Egro, G. (ed.), *Hasan Zyko Kamberi: Poezi, Qendra e Studimeve Albanologjike*, Tiranë, 2016.
- Bogdani, P., *Cuneus prophetarum (Çeta e profetëve), botim kritik përgatitur nga A. Omari*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2015.
- Borgia, N., *Pericope evangelica in lingua albanese del sec. XIV*, Grottaferrata, 1930.
- Budi, P., *Poezi, (Parathënia, tejshkrimi dhe komentet: R. Ismajli)*, ASHAK, Prishtinë, 2006.
- Çabej, E., *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe*, Shtyp. e Ministrisë s'Arsimit, Tiranë, 1936.
- Çabej, E., “Gjon Buzuku”, në *Buletin i Shkencave Shoqërore*, n.1; n.2, 1955.
- Çabej, E., *Tekstet e vjetra shqip dhe disa kriteret rreth botimit të tyre*, në BUSHT, n.2, 1959.
- Çabej, E., *Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes, (botimi III)*, Botime Çabej, Tiranë, 2006.
- Çabej, E., *Shqipja në kapërcyell/Epoka dhe gjuha e Gjon Buzukut*, Botime Çabej, Tiranë, 2006.
- Demiraj, B. (ed.), *Dictionarium latino-epiroticum per R. D. Franciscum Blanchum, (Romæ 1635), Botime Françeskane*, Shkodër, 2008.
- Demiraj, B. (ed.), *Concili Proventiaali o Cuvendi j Arbenit (Romæ 1706), Botim kritik*. Botime Françeskane, Shkodër, 2012.
- Demiraj, B., *Areali kulturor i Veriut në shek. XVI-XVIII*, Botime Onufri, Tiranë, 2017.
- Demiraj, Sh., *Jul Variboba në trashëgiminë e tij (përgatiti për botim B. Demiraj)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2019.
- Domi, M., “Libri i parë shqip dhe fillimet e letërsisë shqipe”, në *Buletin i Shkencave Shoqërore*, n.1, 1955.
- Elsie, R., *Histori e letërsisë shqiptare, (përkthyer në gjuhën shqipe nga A. Myftiu)*, Tiranë, 1997.
- Gurakuqi, M., “Poeti e patrioti Ndre Mjeda”, në *Buletin i Shkencave Shoqërore*, n.3, 1956.
- Hoxha Beqiri, B., *Një histori letërsie e ndaluar, studim historiko-letrar dhe krahasues*, Botime Naimi, Tiranë, 2016.
- Jorgaqi, N., “Bibliografi për letërsinë shqiptare të Rilindjes Kombëtare”, në *Studime për letërsinë shqiptare, I*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1981.
- Kodra, K., “Poemat e De Radës”, në *Studime për letërsinë shqiptare, I*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1981.

- Matranga, L., *E mbsuame e krështerë (a cura di Matteo Mandalà)*. Caltanissetta, 2004.
- Roques, M., *Recherches sur les anciens textes albanais*, L.O.P.Geuthner, Paris, 1932.
- Nadin, L., *Albania ritrovata. Recupero di presenze albanesi nella cultura e nell'arte del Cinquecento veneto, (trad. di Pëllumb Xhufi)*, Botime Onufri, Tiranë, 2012.
- Omari, A., "Tradita letrare e Elbasanit si pasojë e iluminizmit gjuhësor me rrezatim nga Voskopoja", në *Qytetërimi i Voskopojës dhe shekulli i iluminizmit në Ballkan*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2018.
- Paci, E., "Kontributi i Gaetano Petrottës për historinë e letërsisë së vjetër shqipe", në *Hylli i Dritës*, n.1-2, 2015.
- Paci, E., *Studime mbi tekstet e vjetra shqipe*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2017.
- Petrota, G., *Letteratura albanese e italo-albanese*, Venezia, Officine grafiche C.Ferrari, 1939.
- Ressuli, N., *I più antichi testi albanesi*, Giappichelli editore, Torino, 1978.
- Sinani, Sh., *Historishkrimi letrar dhe disa dukuri ndërkulturore*, Botime ASHAK, Prishtinë, 2009.
- Sinani, Sh., *Historia e letërsisë shqipe. Çështje të hapura*, Botime Naimi, Tiranë, 2015.
- Shehri, Dh., *Histori receptimi të letërsisë shqipe (teksti dhe konteksti)*, Botime ASHAK, Prishtinë, 2009.
- Shuteriqi, Dh. S., *Historia e letërsisë shqipe (për shkollat e mesme)*, Tiranë, 1955.
- Shuteriqi, Dh. S.(red.), *Historia e letërsisë shqipe*, Tiranë, 1959-1960.
- Shuteriqi, Dh., *Një manifestim i letërsisë shqiptare në fillimet e Rilindjes Kombëtare*, në *Studime për letërsinë shqiptare, I*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1981.
- Shuteriqi, Dh., *Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879-1800*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2005.
- Xhiku, A., *Veçori të romantizmit në letërsinë arbëreshe*, në *Studime për letërsinë shqiptare, I*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1981.
- Xholi, Z., *Thelbi dhe vlera historike e ideologjisë së Rilindjes kombëtare*, në *Studime për letërsinë shqiptare, I*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1981.
- Zamputi, I., "Çështje të shkrimit dhe të fillimit të letërsisë në gjuhën shqipe", në *Hylli i Dritës*, n.1-2, 1995.

SUMMARY

THE HISTORY OF ALBANIAN WRITTEN LITERATURE IN THEMATIC WORKS WITHIN A SYSTEMATIZING PERSPECTIVE (1950-1985)

With the attention that earned recently again the matter of re-compilation of the history of Albanian written literature, the return to the previous models of its realization constitutes a strong incentive for reflection on the issue of considering the earliest written evidence in Albanian, but also of the entire cultural heritage that is transmitted in chapters, the treatments that are the content of previous publications on the same argument. Watched with a critical eye a few decades later, but also compared among themselves by researchers in the field, such publications, among which some with a school destination, constitute objects of increased attention in recent times, even more so if it is a matter of tracing a methodology of presentation of authors, compilers of works, but also of thematic works on the history of Albanian written literature. In this essay, was selected a period of time (1950-1985) in which several works of this nature have been accomplished, but different among them, and with a non-same trend in the presentation of authorial voices and related works.

